

## **Seminari me temë : Fillimet e Marrëdhënieve Diplomatike Çekosllovak-Shqiptare gjatë sundimit të Ahmet Zogut: Nga këndvështrimi i Diplomacisë Çekosllovak nga Z. Matěj Křepinský**

Universiteti i Tiranës në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës Çeke dhe me Ambasadën e Republikës Sllovakë do të organizojnë një seminar me ligjerues Z. Matěj Křepinský me titull: Fillimet e Marrëdhënieve Diplomatike Çekosllovak-Shqiptare gjatë sundimit të Ahmet Zogut: Nga këndvështrimi i Diplomacisë Çekosllovakë.

Seminari do të fokusohet në çështjen e raporteve politike, ekonomike dhe tregtare të dy shteteve, duke marrë parasysh zhvillimin e Misionit Çekosllovak në Tiranë, që u hap në vitin 1925. Relacionet diplomatike që përmbajnë përshkrimin e marrëdhënieve dypalëshe nga pikëpamja e vetë diplomatëve që punonin në Shqipëri u dërguan në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Pragë në periudhën mes dy luftërave. Këto relacione janë burimi kryesor, falë të cilit mund të shqyrtojmë dhe analizojmë fillimet e kontakteve çekosllovak-shqiptare.

Aktiviteti do të zhvillohet në Rektoratën e Universitetit të Tiranës më 18 tetor 2018, ora 10.30, Salla e Senatit Akademik.

# FTESË

**Fillimet e Marrëdhënieve Shqiptaro –  
Çekosllovake në Kohën e Qeverisjes së Ahmet  
Zogut:  
*Pikëpamja e Diplomacisë Çekosllovake***

**18 Tetor 2018  
10:30  
Universiteti i Tiranës**

**Ambasada e Republikës Çeke  
në bashkëpunim me  
Ambasadën e Republikës Sllovaqe  
dhe  
Universitetin e Tiranës**

**Kanë kënaqësinë t'ju ftojnë  
Në një seminar që hulumton mbi Diplomacinë  
Çekosllovake në Shqipëri në periudhën midis  
Luftës së Parë dhe Luftës së Dytë Botërore**

**Ligjërues: Z. Matěj Křepinský, autor i tezës: Koha e Ahmet Zogut nga**

**Pikëpamja e Diplomacisë Çekosllovake**

*Prezantimi dhe diskutimi do të mbahen në gjuhën shqipe me përkthim në gjuhën angleze.*

**Vendi: Rektorati, Universiteti i Tiranës, Salla e Senatit Akademike, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë**



Embassy of the Czech Republic  
in Tirana



EMBASSY  
OF THE SLOVAK REPUBLIC  
IN TIRANA

**1918  
100  
2018  
CZECH AND SLOVAK  
CENTURY**

